


VLERËSIMI I PROGRAMIT TË EDUKIMIT PËR KARRIERËN

Vlerësimi është procesi i përcaktimit të vlerës dhe efektshmërisë së një programi mësimdhënieje. Ai është një mjet i cili ndihmon mësuesit të gjykojnë nëse një kurrikul po zbatohet ashtu siç është planifikuar dhe për të vlerësuar se deri në çfarë mase po arrihen objektivat. Ai përdoret për të analizuar dhe vlerësuar punën e bërë gjatë një viti shkollor. Ai i jep mundësinë mësuesve që t'i përgjigjen pyetjes:

- *A jemi duke bërë për nxënësit tanë atë që kemi thënë që do bëjmë?*
- *A janë nxënësit tanë duke mësuar ato gjëra që ne kemi përcaktuar që ato duhet të mësojnë?*
- *A është e nevojshme që të përmirësojmë metodat tona të mësimdhënies?*

Hapat e procesit të vlerësimit



Hapi 1:

Përcaktimi i qëllimit të vlerësimit

Hapi i parë është planifikimi për përcaktimin e qëllimit të vlerësimit. Përcaktimi i qëllimit përfshin marrjen e vendimit në lidhje me objektivat e vlerësimit, dhe për kë do të përgatiten rezultatet e vlerësimit. Qëllimet dhe objektivat e vlerësimit mund të ndryshojnë në varësi të programit apo kurrikulës mësimore e cila po vlerësohet, nëse ajo është e re apo është duke u provuar, gjë për të cilën planifikimi dhe implementimi ka nevojë të dokumentohet, ose nëse një kurrikul është testuar plotësisht dhe ka nevojë për dokumentacion për sukseset e saj përpara se informacioni të shpërndalet gjerësisht tek persona të tjerë të interesuar.

Hapi 2:

Specifikimi i pyetjeve vlerësuese

Pyetjet e vlerësimit dalin nga qëllimet dhe objektivat e specifikuar në hapin e mëparshëm. Ato do të strukturohen për të adresuar nevojat e audiencës specifike të cilës i drejtohet. Pyetjet e vlerësimit duhet të bëhen për secilin komponent i cili përfshihet në qëllimet që janë specifikuar në hapin e mëparshëm.

Për shembull, mund të formulohen pyetje të cilat kanë të bëjnë me përshtatshmërinë e kurrikulës dhe përvojën e stafit mësimor; pyetje të tjera mund të lidhen me përshtatshmërinë e aftësive apo informacionit që po u jepet nxënësve; dhe në fund, pyetjet e vlerësimit mund të lidhen me masën në të cilën nxënësit po arrijnë objektivat e përcaktuara nga programi mësimor.

Hapi 3:

Hartimi i planit të mbledhjes së të dhënave

Plani i mbledhjes së të dhënave është në fakt një hartë për kryerjen e vlerësimit. Një pjesë e rëndësishme e planit është hartimi ose zgjedhja e instrumenteve për mbledhjen dhe regjistrimin e të dhënave të nevojshme për t'ju përgjigjur pyetjeve të vlerësimit. Instrumentet e mbledhjes së të dhënave mund të përfshijnë formularë të regjistrimit të informacionit, pyetësorë, intervista, teste apo forma të tjera vlerësuese. Disa nga instrumentet mund të jenë të gatshme p.sh testet standarde. Disa të tjera do të modifikohen për të përmbushur nevojat e vlerësimit. Në raste të tjera, do të duhet të krijohen instrumente të tjera.

Hapi 4:

Mbledhja e të dhënave

Mbledhja e të dhënave duhet të ndjekë planet e zhvilluara në hapin e mëparshëm. Procedura standarde duhet të ndiqen me qëllim që të dhënat të jenë të besueshme dhe

të vlefshme. Të dhënat duhet të regjistrohen me kujdes me qëllim që ato të mund të përmbliidhen gjatë fazës analizuese.

Regjistrimi siç duhet është po aq i rëndësishëm me qëllim që të dhënat të mos humbasin dhe të përdoren për qëllimet e caktuara në fillim të vlerësimit. Devijimet nga plani i mbledhjes së të dhënave duhet të dokumentohen me qëllim që ato të merren në konsideratë gjatë analizës dhe interpretimit të të dhënave.

Hapi 5:

Analizimi i të dhënave dhe përgatitja e raportit

Ky hap përfshin përmbledhjen dhe interpretimin e të dhënave të mbledhura. Vlerësimi nuk mbaron derisa të bëhet një raport dhe rezultatet ti paraqiten drejtuesve apo vendim-marrësve përkatës. Në përgatitjen e një raporti, personat përgjegjës duhet të jenë të qartë se kush është audiencia të cilës raporti i drejtohet.

Dy pyetje duhet të merren në konsideratë:

- (1) *Çfarë ka nevojë të dijë audiencia në lidhje me rezultatet e vlerësimit?*
- (2) *Si mund të prezantohen këto rezultate në mënyrën më të mirë të mundshme?*

Audiencia të ndryshme kanë nevojë për nivele të ndryshme informacioni. Drejtuesit kanë nevojë për informacion të përgjithshëm për marrjen e vendimeve ndërsa mësuesit mund të kenë më shumë nevojë për informacion i cili fokusohet tek veprimtaritë e programit dhe efektet që ka ai tek pjesëmarrësit.

Raporti duhet të mbulojë pikat e mëposhtme:

- Qëllimet e vlerësimit;
- Procedurat dhe metodat e përdorura;
- Gjetjet;
- Kuptimet e gjetjeve, duke përfshirë rekomandimet për ndryshime dhe përmirësime të programit.

Më e rëndësishmja, raporti duhet të jetë i organizuar me qëllim që të adresojë qartë të gjitha pyetjet vlerësuese të specifikuara në Hapin 2.


Hapi 6:

Përdorimi i Raportit të Vlerësimit për të përmirësuar programin

Vlerësimi nuk duhet të konsiderohet i suksesshëm derisa rezultatet e tij të përdoren për të përmirësuar mësimdhënien dhe suksesin e nxënësve. Në fund të fundit, kjo është arsyeja pse ai po bëhet. Vlerësimi mund të tregojë që një veprimtari mësimdhënieje nuk po implementohet sipas planit, ose ai mund të tregojë që një objektivi i caktuar nuk po arrihet. Në një rast të tillë, është përgjegjësia e mësuesve dhe drejtuesve që të bëjnë

ndryshimet përkatëse për të rregulluar situatën. Shkollat nuk duhet të jenë kurrë të kënaqura me programet e tyre. Përmirësime mund të bëhen gjithmonë, dhe vlerësimi është një mjet i nevojshëm për të arritur këtë qëllim.

CIKLI I VLERËSIMIT



Ai përdoret për të:

- ✓ Zbuluar cilësinë dhe vlerën e proceseve dhe rezultateve të të mësuarit që lidhen me karrierën;
- ✓ Gjykuar aktivitetet, ngjarjet dhe të mësuarit .

Ai mund të:

- ✓ Asistojë në mësimdhënie;
- ✓ Inkurajojë zhvillimin e kurrikulave;
- ✓ Përmirësojë llogaridhënien.

Qëllimi:

- ✓ Cili është fokusi kryesor i vlerësimit?
- ✓ Pse jeni duke vlerësuar procesin e edukimit për karrierën?
- ✓ Kush duhet të dijë rezultatet?
- ✓ Çfarë do të bëni me to?

Rezultatet e synuara:

- ✓ Çfarë do të arrijë vlerësimi?
- ✓ Cili është qëllimi i vlerësimit: çfarë mund të bëjë dhe çfarë nuk mund të bëjë ai?
- ✓ A do t'i përgjigjet vlerësimi pyetjeve specifike apo do të japë një "fotografi të çastit" të një situatë të përgjithshme?
- ✓ A do të përqendrohet në fakte, opinione apo në të dyja?
- ✓ Cili është harku kohor për vlerësimin?

Mbledhja e të dhënave:

- ✓ Çfarë lloj të dhënash do të mblidhen: cilësore apo sasiore?
- ✓ Cilat janë metodat më të përshtatshme për t'u përdorur në mbledhjen e të dhënave?
- ✓ Çfarë stafi duhet të përfshihet?

Analiza dhe raportimi në lidhje me gjetjet:

- ✓ Mblidhni dhe prezantoni të dhënat
- ✓ Nxirrni një raport vlerësimi me përfundime dhe rekomandime
- ✓ Merrni parasysh ndonjë mangësi ose mospërputhje tek të dhënat

Prezantimi dhe Diskutimi i Gjetjeve:

- ✓ Kujt do t'ja prezantoni të dhënat dhe si?
- ✓ Çfarë doni ju që të ndodhë më vonë?

Plani i Zhvillimit:

- ▶ Çfarë duhet të ndodhë tani, p.sh., një plan veprimi ku të vëmë rekomandimet në praktikë, kërkime të mëtejshme, konsultim, zhvillim programi.

RAPORTI I VETËVLERËSIMIT

PËRSHKRIMI I SHKOLLËS

- Propozimet për implementim;
- Burimet e përdorura;
- Planet mësimore;
- Metodatat e mësimdhënies.

GJYKIMI I PËRGJITHSHËM

- Efektiviteti i Përgjithshëm;
- Kapaciteti për përmirësim.

PËRMBLEDHJA E GJETJEVE

- Fuqitë Kyçe;
- Fushat e Përmirësimit.

GJETJET KRYESORE

- Rezultatet e Nxënësve;
- Nxënësit në mënyrë të përshtatshme arrijnë qëllimet e tyre individuale dhe ecin përpara;
- Hartimi i planit të veprimit për nxënësit është i kënaqshëm;
- Nxënësit kalojnë tek të mësuarit e mëtejshëm ose puna është e kënaqshme;
- Përmirësimi i vetë-besimit, motivimit dhe marrjes së vendimeve të nxënësve është i mirë;
- Metodatat e përdorura për të ndihmuar nxënësit për të kaluar pengesat janë të mira.

CILËSIA E OFRIMIT

- Vlerësimi;
- Vëzhgimet;
- Burimet.

LIDERSHIPI DHE MENAXHIMI

- Mbështetja e drejtuesve të shkollës.

BARAZIA DHE DIVERSITETI

- Planet mësimore marrin parasysh barazinë dhe çështjet e diversitetit.

SFIDAT KYÇE

- Çështjet kryesore të identifikuara nga projekti pilot.

EDUKIMI PËR KARRIERËN: Raporti i Vetë-vlerësimit

| | |
|---|--|
| PËRSHKRIMI I SHKOLLËS <ul style="list-style-type: none">▪ Propozimet për implementim▪ Burimet e përdorura▪ Planet mësimore▪ Metodatat e mësimdhënies | |
| GJETJET KRYESORE <p>Rezultatet e Nxënësve Nxënësit në mënyrë të përshtatshme arrijnë qëllimet e tyre individuale dhe ecin përpara. Hartimi i planit të veprimit për nxënësit është i kënaqshëm. Nxënësit që kalojnë tek të mësuarit e mëtejshëm ose puna është e kënaqshme. Përmirësimi i vetë-besimit, motivimit dhe marrjes së vendimeve të nxënësve është i mirë. Metodat e përdorura për të ndihmuar nxënësit për të kaluar pengesat janë të mira.</p> | |
| CILËSIA E OFRIMIT <p>Vlerësimi</p> <ul style="list-style-type: none">▪ Vëzhgimet▪ Burimet | |
| LIDERSHIPI DHE MENAXHIMI <p>Mbështetja e drejtuesve të shkollës</p> | |
| BARAZIA DHE DIVERSITETI <p>Planet mësimore marrin parasysh barazinë dhe çështjet e diversitetit</p> | |
| SFIDAT KYÇE <p>Çështjet kryesore të identifikuara nga projekti pilot</p> | |

VLERËSIMI I PROGRAMIT TË EDUKIMIT PËR KARRIERËN

| | |
|--|--|
| Qëllimi | |
| Rezultatet e Synuara | |
| Mbledhja e të dhënave <ul style="list-style-type: none">• Planet Mësimore• Programi i Kurrikulës• Pyetëtori për nxënësit | |
| Analiza | |
| Prezantimi dhe Diskutimi | |

PËRFITIMET E VLERËSIMIT

| | |
|--------------|---|
| Për shkollën | <ul style="list-style-type: none">• Një siguri që kjo lëndë po kontribuon për qëllimin e tërësishëm të shkollës në arritjen e objektivave.• Një mundësi për të testuar Edukimin për Karrierën tërësisht për efektshmërinë e tij si program dhe duke përdorur gjetjet nga vlerësimi të përmirësohet në vazhdimësi. |
| Për mësuesit | <ul style="list-style-type: none">• Prova në lidhje me rezultatet e mësimdhënies• Kontroll i vlefshmërisë së planeve mësimore dhe metodave të mësimdhënies• Kuptim i tërësishëm i rolit që dhënia e kësaj lënde mund të luajë. |
| Për nxënësit | <ul style="list-style-type: none">• Një siguri që zhvillimi personal që është rezultat i të mësuarit po regjistrohet siç duhet.• Një mundësi për të shprehur opinionin e tyre në lidhje me mësimin e marrë.• Një mundësi për të përmirësuar programin e lëndës së edukimit për karrierën për brezat që do të vijnë. |